“B&B STONE” SHPK

Nipt: K73627001A

PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE

Shfrytëzimi në sipërfaqe i mineralit ranor masiv

- ***KLASIFIKIMI I AKTIVITETIT SIPAS LIGJIT TË VNM-ve***
  SHTOJCA 1. PIKA 19. GURORE DHE MINIERA SIPËRFAQËSORE, KU SIPËRFAQJA E VENDIT ËSHTË MBI 0,5 HEKTARË.

- ***KLASIFIKIMI I AKTIVITETIT SIPAS LIGJIT PËR LEJET E MJEDISIT:***
  ID 3.7. NXJERRJA E MINERALEVE, RËRËS DHE ARGJILËS NGA MINIERAT ME SHFRYTËZIM NË QIELL TË HAPUR DHE NGA GURORET.

VENDI I USHTRIMIT TE AKTIVITETIT:

Berat Roshnik BOGDAN I POSHTEM Fshati Bogdan i Poshtem, lagjja Frashtan, karriere minerali ranor silicor.

1. PROFILI I OPERATORIT DHE PROJEKTI

Shoqëria **B&B STONE SH.P.K**. e regjistruar pranë QKB me Nr.NIPT **K73627001A**, do të pajisjet me leje mjedisi të tipit B për të ushtruar aktivitetin e **shfrytëzimit në sipërfaqe të mineralit ranor masiv.**

- ***KLASIFIKIMI I AKTIVITETIT SIPAS LIGJIT TË VNM-ve***
  SHTOJCA 1. PIKA 19. GURORE DHE MINIERA SIPËRFAQËSORE, KU SIPËRFAQJA E VENDIT ËSHTË MBI 0,5 HEKTARË.

- ***KLASIFIKIMI I AKTIVITETIT SIPAS LIGJIT PËR LEJET E MJEDISIT:***
  ID 3.7. NXJERRJA E MINERALEVE, RËRËS DHE ARGJILËS NGA MINIERAT ME SHFRYTËZIM NË QIELL TË HAPUR DHE NGA GURORET.

B&B STONE SH.P.K. zotëron lejen minerare me PN-9645-12-2019 për shfrytëzimin e mineralit ranor masiv.



2. VENDNDODHJA E USHTRIMIT TE AKTIVITETIT

Aktiviteti do të zhvillohet në **Berat Roshnik BOGDAN I POSHTEM Fshati Bogdan i Poshtem, lagjja Frashtan, karriere minerali ranor silicor.**

Nr.	X	Y
1.	4420380	4507172
2.	4420510	4507369
3.	4420510	4507770
4.	4420028	4507702
5.	4420002	4507520
6.	4420262	4507593
7.	4420280	4507295
8.	4420253	4507178

******Sipërfaqja e zonës së lejuar minerare është 0.017km^2.***



3. PROCESI TEKNOLOGJIK

Ky aktivitet përfshin shfrytëzimin në sipërfaqe të mineralit ranor masiv, i cili përbëhet kryesisht nga rërë kuarcore ose përbërës të ngjashëm me përdorim ndërtimor dhe industrial.

Procesi do të zhvillohet në një zonë të përcaktuar sipërfaqësore përmes metodave mekanike të gërmimit me mjete (eskavatorë, karroca transportuese, etj.).

Aktiviteti përfshin gjithashtu pastrimin dhe përgatitjen e terrenit, gërmimet në shtresat minerale, ndarjen e materialeve të dobishme nga ato të padobishme dhe rikultivimin e zonës pas përfundimit të shfrytëzimit.

Të dhëna teknike të shfrytëzimit:

- Rezervat gjeologjike: 392,600 m³
- Rezervat e nxjerrshme: 298,350 m³
- Prodhimi i planifikuar vjetor: 6,000 m³
- Prodhimi total i planifikuar: 52,500 m³

Fuqia punëtore:

Aktiviteti do të zhvillohet me një fuqi punëtore prej 10 punonjësish, të cilët do të angazhohen në operacionet e shfrytëzimit, mirëmbajtjes së pajisjeve, transportit dhe menaxhimit të mjedisit.

Masat mjedisore të planifikuara:

- Reduktimi i emetimeve të pluhurit përmes ujitjes së rrugëve të brendshme dhe përdorimit të materialeve mbuluese
- Menaxhimi i mbetjeve inerte dhe mineralit të padobishëm në venddepozitime të përcaktuara
- Rikuperimi progresiv i sipërfaqes së shfrytëzuar me mbjellje vegjetacioni lokal
- Mbajtja nën kontroll e ndikimeve në zhurmë dhe vibrime në përputhje me VKM-të dhe standardet mjedisore.

Ky shfrytëzim kryhet në përputhje me standardet teknike, ligjore dhe mjedisore në fuqi, duke synuar minimizimin e ndikimeve negative në mjedis dhe komunitetin përreth.

4. NDIKIMET NEGATIVE NE MJEDIS

NDIKIME NË AJËR

Aktiviteti i shfrytëzimit të karrierës në sipërfaqe do të shoqërohet me emetime të pluhurit (grimca të ngurta) gjatë fazave të gërmimit, ngarkim-shkarkimit dhe fraksionimit të mineralit ranor. Për të reduktuar shkarkimet në ajër, subjekti do të aplikojë lagien me ujë të rrugëve dhe zonave aktive gjatë periudhave të thata. Këto masa synojnë uljen e përhapjes së pluhurit dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit në zonën përreth.

NDIKIME NË TOKË

Ndikimet në mjedisin tokësor lidhen kryesisht me lëvizjen e mjeteve të tonazhit të rëndë për transportin e mineralit. Lëvizja e tyre mund të shkaktojë ngjeshje të tokës dhe degradim të sipërfaqes rrugore. Aktiviteti i shfrytëzimit do të shoqërohet me rehabilitim progresiv të sipërfaqes së prekur, duke zbatuar protokollet dhe planet e rehabilitimit të miratuara nga autoritetet përkatëse.

NDIKIME NË UJËRA

Përdorimi i ujit do të jetë i kufizuar dhe do të aplikohet vetëm për sprucim me qëllim uljen e pluhurit. Ky ujë do të shpërndahet në mënyrë të kontrolluar dhe nuk do të krijojë rrjedha. Si rezultat, nuk parashikohen shkarkime në ujërat sipërfaqësore, nëntokësore apo në rrjete kanalizimi. Aktiviteti nuk do të gjenerojë ujëra të ndotura teknologjike.

NDIKIME NË KLIMË

Ky aktivitet nuk do të shkaktojë ndryshime të ndjeshme në karakteristikat klimaterike të zonës. Nuk priten ndikime në temperaturë, rryma ajrore, reshje ose lagështi. Zhvillimi i projektit nuk ka ndikim në klimën lokale ose më gjerë.

NDIKIME NGA ZHURMAT

Zhurmat do të gjenerohen kryesisht gjatë operacioneve të gërmimit dhe transportit të mineralit. Megjithatë, duke qenë se zona e shfrytëzimit ndodhet larg mjediseve të banuara, nuk pritet të ketë ndotje akustike me ndikim në popullatë. Nivelet e zhurmës do të jenë të kufizuara në perimetrin e zonës së aktivitetit.

NDIKIME NË POPULLËSI

Projekti nuk përfshin lëvizje ose zhvendosje të popullësisë. Aktiviteti nuk përfshin emetime në ajër, ujë apo tokë që mund të ndikojnë në shëndetin e punonjësve ose komunitetit përreth. Subjekti do të ndërmarrë masa sigurie dhe do të zbatojë praktika të mira operacionale për mbrojtjen e punonjësve.

NDIKIME NË FLORË DHE FAUNË

Zona ku zhvillohet aktiviteti nuk përmban elementë të veçantë të biodiversitetit. Nuk janë evidentuar specie të mbrojtura ose habitate me rëndësi ekologjike. Pas përfundimit të fazave të shfrytëzimit, sipërfaqet do të rehabilitohen me metoda ekologjike, në përputhje me planin përkatës të rehabilitimit të hartuar nga ekspertë të fushës.

TRAJTIMI I MBETJEVE

A. Mbetje të ngurta urbane

Mbetjet e ngurta urbane do të gjenerohen kryesisht nga punonjësit në vendin e punës (mbetje organike, plastike, letër, etj.). Ato do të mblidhen në mënyrë të organizuar dhe do të dërgohen çdo ditë në pikën e grumbullimit të përcaktuar nga Pushteti Vendor. Pushteti vendor do të jetë përgjegjës për trajtimin e mëtejshëm të tyre.

B. Mbetje nga procesi teknologjik

Mbetjet inerte që mund të gjenerohen gjatë shfrytëzimit (materiale të papërshtatshme për treg, fragmentet e mineralit, etj.) do të ripërdoren për qëllime rikuperimi dhe rehabilitimi të objektit minerar.

B&B STONE SHPK

Administrator

Julia Bojaxhiu

Ekspert mjedisi

Ismet Kurti